

VENDIM
Nr. 36/2024

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
93/2017, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; si dhe të neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr.1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE
TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
I. KRYETAR	(2)	
	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR	(36)	
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-1	(1)
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE	(15)	
DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	6
Specialist jurist	IV-1	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II-1	2
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II-1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(11)
Drejtor	1-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	2
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT **	IV-1	1
Specialist protokoll/arkivi ***	IV-1	2
Magaziniere	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Total		76

Shënim.

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkiv përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Përfutimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*